

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, me date 08 Gusht 2018 (dymije e tetemdhjete) nenshkruhet kjo kontrate mes paleve:

Z. Andi Kohila, shtetase shqiptare, i biri i Faikut, lindur me 29.05.1988 ne Tirane e banuese ne Tirane, mbajtese e letemjofimit ID me nr. 0244226552 dhe nr. personal 180529060L, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar;

(ne vijim referuar si "Shitesi")

dhe

Z. Bredi Kohila, shtetase shqiptare, i biri i Faikut, lindur me 11.06.1991 ne Tirane e banuese ne Tirane, mbajtese e letemjofimit ID me nr. 032540510 dhe nr. personal J10611056F, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar;

(ne vijim referuar si "Bleresi")

Ne vijim e per efekt te kesaj Kontrate, Shitesi dhe Bleresi do te referohen vecmas si Pale/a dhe se bashku si Pale/t.

MEQENESE:

- A. Shoqeria "Brand & Co" Sh.P.K., eshte nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar e krijuar e qe funksionon ne perputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me Numer Unik Identifikimi L81329028A, me kapital themeltar 2.000.000,00 Leke, te zoteruara ne masen 100% nga Ortaku Andi Kohila (me poshte referuar "Shoqeria").
- B. Shitesi deshiron te transferoje 50% te kapitalit te zoteruar prej tij ne Shoqeri dhe Bleresi ka pranuar te bleje 50% te kapitalit te zoteruar dhe te ofruar nga Shitesi ne Shoqeri;
- C. Ne zbatim te kerkesave te Statutit te Shoqerise, Palet kane vendosur te lidhin kete Kontrate;

ATEHERE, duke qene se ekzistojne keto kushte paraprake, per te cilat Palet nuk kane pretendirne apo kundershitime. Palet bien dakord per sa me poshte vijon:

Neni 1 Objekti

1.1 Nepermjet kesaj Kontrate Shitesi i shet Bleresit 50% te kapitalit te zoteruar prej tij ne Shoqeri dhe Bleresi blen nga Shitesi 50 % te kapitalit te zoteruar nga Shitesi ne kapitalin themeltar te Shoqerise "Brand & Co" Sh.P.K., shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me Numer Unik Identifikimi NUIS L81329028A.

Neni 2 Cmimi

- 2.1 Cmimi i shitjes se 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit te zoteruar nga Shitesi ne shoqeri eshte 1.000.000 LEKE (nj milion leke).
- 2.2 Cmimi i siperpendur i shitjes eshte paguar teresisht nga bleresi tek shitesi para nenshkrimet te kontrates, dhe palet konfirmojne se nuk kane pretendirne ne lidhje me cmimin e shitjes dhe menyren e pageses.

Neni 3 Deklarimet dhe garancite



- 3.1 Shitesi deklaron dhe verteton se ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate ai zoteron kuotat qe do te transferohen sipas kesaj Kontrate, dhe ka te drejten per **ti** transferuar keto kuota dhe se nenshkrimi apo zbatimi i kesaj Kontrate nga Shitesi nuk vjen ne kundershtrim me ligjet, Statutin, kontratat, marreveshjet apo dokumente te tjera ligjore, subjekt i te cilave eshte Shitesi.
- 3.2. Bleresi deklaron dhe verteton se ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate Bleresi ka tagra te plota per te pranuar kuotat nga Shitesi sipas percaktimeve te kesaj Kontrate dhe se nenshkrimi apo zbatimi i kesaj Kontrate nga Bleresi nuk vjen ne kundershtrim me ligjet, Statutin, kontratat, marreveshjet apo dokumente te tjera ligjore, subjekt i te cilave eshte Bleresi.

Neni 4 Transferimi i til drejtave mbi kuotat


- 4.1. Pronesia mbi kuotat e Shoqerise, objekt i kesaj Kontrate, kalon nga Shitesi te Bleresi menjehere me nenshkrimin e kesaj Kontrate dhe qe nga ky moment Bleresit i lind e drejta e regjistrimit te kesaj kontrate ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe Shitesi bie dakort per kete.
- 4.2. Menjehere me nenshkrimin e kesaj kontrates Bleresi behet ortak i Shoqerise duke zoteruar 50% te kapitalit te saj.
- 4.3. Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Bleresi gezon te gjitha te drejtat per te regjistruar pronesine mbi kuotat e zoteruara ne emer te tij ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Bisnesit si dhe prane cdo institucioni tjeter shtetor sipas legjislacionit ne fuqi dhe per ndjekjen e kesaj procedure autorizon Z. Fabjan Dici, mbajtes i letemjofitimit ID me nr. 028791732 dhe nr. Personal I61127049B.

Neni 5 Te ndryshme

- 5.1. Cdo kusht, klauzole apo parashikim i kesaj Kontrate do te jete i vlefshem pavaresisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve te tjera dhe vlefshmeria e nje kushti, klauzole apo parashikimi nuk do te cenohet nga pavlefshmeria e nje kushti, klauzole apo parashikimi tjeter.
- 5.2. Kjo Kontrate do te interpretohet dhe zbatohet ne perputhje me dispozitat e Ligjit 990112008, te ndryshuar dhe Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.
- 5.3. Cdo konflikt qe ka lindur si pasoje apo lidhet me kete Kontrate do te zgjidhet ne marreveshje ndermjet Paleve, ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e konflikteve eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.
- 5.4. Kjo Kontrate hartohet ne gjuhen Shqipe ne 4 (kater) origjinale.

Lexuar, pranuar e nenshkruar nga palet.

SHITESI
Andi Kohila

ANDI KOHILA


BLERESI
Bredi Kohila

Bredi Kohila
